

VENDIM
Nr. 737, datë 27.11.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 35, DATË
18.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT, TË ORGANIZIMIT DHE TË SHPËRBLIMIT TË KËSHILLIT
KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT (KKDA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 35, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Emërimi dhe lirim i anëtarëve bëhet nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, sipas pikës 1, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar. Emërimi i anëtarëve bëhet duke marrë parasysh shmangien nga çdo interes direkt ose indirekt i mundshëm i tyre me subjektet, që ndikohen nga vendimet e KKDA-së, si dhe duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

a) të zotërojë diplomë universitare të nivelit “Bachelor” dhe “Master i shkencave” ose “Master profesional” në shkenca juridike/shkenca ekonomike dhe në fushën e arteve;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune profesionale në fushat e sipërpërmendura.”.

2. Kudo në tekstin e vendimit, pas citimit të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, shtohet fjala “... i ndryshuar ...”.

3. Në pikën 5, të kreut II, pas fjalëve “... të nenit 156 ...” shtohen “... dhe pikave 5 e 9, të nenit 138 ...”.

4. Pika 8, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Kryetari i KKDA-së thërret mbledhjet menjëherë me marrjen e kërkesës, në zbatim të pikës 4, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e KKDA-së. Numri i mbledhjeve që zhvillon KKDA-ja si rregull është 5 (pesë) dhe zhvillohen brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës.”.

5. Pika 20, e kreut II, shfuqizohet.

6. Pika 1, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.”.

7. Në pikën 2, të kreut III, emërtesa “... Ministria e Kulturës ...” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit ...”.

II. Ngarkohet ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku